

Migrimi/ shtegëtimi


Lejleku i bardhë është lloj shtegëtar i çili kryesisht dimëron në Afrikë ndërsa kthehet në territoret e folezimit zakonisht në muajt mars dhe largohet drejt Afrikës në muajt gusht-shtator.

Shtegëtimi i tyre në vjeshtë lidhet me mungesën e ushqimit gjatë periudhës së dimrit.

Ato udhëtojnë deri në Afrikën Jugore deri në 12,000 km (vetëm në një drejtim).

Lejlekët udhëtojnë në koloni vetëm ditën duke përdorur rrymat e ngricës së ajrit.

Në vjeshtë, mund të shihen koloni deri afër 10,000 individ.



Statusi ligjor

Lejleku i bardhë është i mbrojtur tek në një mënyrë strikte.

Ai gjithashtu gëzon mbrojtje edhe në nivel ndërkombëtar.

Gjatë vitit 2018 me iniciativën e Institutit për Mbrojtjen e Natyrës në bashkëpunim me KEDS-in janë vendosur disa platforma me fole mbi shtyllat elektrike ku kanë qenë të vendosura më para fole të lejkëve.

Shitja e lëta të Shetit në muajt nga Rufford Small Grant në kuadër të projektit "Rrumbulla e Lejkëve të bardhë (Ciconia ciconia) në Kosovë përmes inventarizimit dhe restaurimit të foleve"

Përgatiti: Dr.sc. Qenan Mashumi



Lejleku i bardhë (Ciconia ciconia)



PRISHTINË, 2019



Përshkrimi

Lejleku i bardhë (*Ciconia ciconia* L., 1758) është njëri prej dy llojeve të lejkëve që gjenden tek ne.

Është një shpend i madh me gjatësi të trupit prej 90-110 cm dhe gjatësi të hapjes së krahëve prej 155-215 cm.

Trupin e kanë të bardhë, përveç males të krahëve që është me ngjyrë të zeze.

Tek të rriturit sqepit dhe këmbët janë me ngjyrë të kuqe, derisa të të vegjëlit është me ngjyrë të errët.

Përhapja

Haset kryesisht në livadhe të hapura e të lagta, llogarita, toka bujqësore etj.

Është lloj folezues çati në tërë Evropën ashtu edhe tek.

Fole në ndërtim kryesisht në vendbanime edhe atë kryesisht në majë të objekteve të larta si pemë, shtylla të tensionit, kulme dhe oxhaqe të shtepiave etj.

Të vegjëlit e tyre përrijnë të kthehen atje ku kanë çelur.

Ushqimi

Lejlekët ushqehen në mënyrë të llojlloshme si: insekte, kërmij, peshaj, braktosë, gjarpërdnie, hardhuca por edhe gjitacë të vegjël (muj dhe leau) të cilët më parë i vrasin me saop.

Është një erarritës në kuadrimin e vërtetë të fialës.



Riprodhimi

Riprodhimi i tyre fillon në pranverë.

Megjithatë lejlekët riparojnë fole të tyre çdo vit në pranverë, fole të tyre shumë të vjetra mund të jenë të larta mbi 5 m, me diametër deri në 2 m dhe mund të peshojnë deri në një ton.

Femra zakonisht lëshon 3-5 vezë dhe qendrojnë mbi vezë në mënyrë alternative si meshkujt ashtu edhe nga femrat 33-34 ditë.

Bashkarisht kujdesen edhe për zoatë që fillojnë fluturimin pas 56-64 ditësh.

Lejlekët bëhen "prindër" në vitin e tyre të tretë ose të pestë.

Siellja

Lejlekët e bardhë janë qenie shoqërore dhe koloniale ku çiftet qëndrojnë së bashku gjatë tërë jetës.

Lejlekët zakonisht shprehin ndjenjat e tyre duke komunikuar mes vete me anë të sqepit, mjet ky i pëzakontë por që gjinë të përdorin atë me shumë shkaktësi.



Zëri

Është lloj zakonisht i heshtur mirëpo lehtë dallohet përmes përplasjes të fortë të sqepit sidomos kur takohen me partnerin në fole.